

## 13.2 KATALOGIMI NË SHKRIMIN CIRILIK OSE NË KOMBINIMIN CIRILIK DHE LATIN

Në sistemet COBISS, në shtetet ku përdorin shkrimin cirilik, katalogimi mund bëhet në shkrimin cirilik, latin ose në kombinimin e dy llojeve të shkrimit.

Të dhënat nga burimet bibliografike në gjuhët, të cilat përdorin shkrimin cirilik dhe latin, transferohen në regjistrimet bibliografike në shkrimin origjinal. Të dhënat në gjuhët e tjera mund të transliterohen në shkrimin latin ose shënohen në shkrimin origjinal. Se cilat të dhëna vendosen në shkrimin origjinal dhe cilat transliterohen është kompetencë e qendrave të veçanta kombëtare.

Në sistemet COBISS, në të cilat gjuha e katalogimit është kryesisht në shkrimin cirilik (p.sh. gjuha bullgare, maqedone), shënimet dhe të dhënat e tjera shënohen në shkrim cirilik. Në sistemet COBISS, në të cilat gjuha e katalogimit është në dy lloje të shkrimit (p.sh. gjuha serbe), shënimet dhe të dhënat e ngjashme shënohen në të njëjtin lloj të shkrimit, në të cilin është pjesa e kryesore e përshkrimit bibliografik.

Emërtimet për emrat vetjakë dhe emërtimet lëndore, në regjistrimet bibliografike shënohen nën kontroll të njësuar ose jo. Shkrimi i emërtimeve pa kontroll të njësuar dhe formave të tyre alternative është përcaktuar me rregullat lokale të katalogimit.

Shënimi i emërtimeve me kontroll të njësuar bëhet përmes regjistrimeve të njësuara me pikëqasjet në shkrimet alternative, në shkrim cirilik dhe latin.

---

### 13.2.1 Shënimi i të dhënave

Në sistemet COBISS, në të cilat emërtimet për emrat vetjakë janë të shënuara në të dy llojet e shkrimit, ndërkohë shënimi i emrave vetjakë nën kontrollin e njësuar ende nuk është rregulluar, ekziston marrëveshja për shënimin e detyrueshëm të emërtimeve për emrat vetjakë edhe në shkrimin alternativ në fushat përkatëse:

- 90X (treg. 2 = 0, 3) në shkrim latin
- 90X (treg. 2 = 1, 4) në shkrim cirilik

Me përdorimin e metodës **Redaktimi / Shndërro në shkrim latin dhe Redaktimi / Shndërro në shkrim cirilik serb/maqedon** mund të shndërrohet në mënyrë automatike nënfushat, përkatësisht pjesën e përmbajtjes nga shkrimi cirilik në latin dhe anasjelltas (shih kap. 7.3.1, pika 4).



Shënim:

*Kur të përzgjidhni shënimin në shkrimin e caktuar, duhet të keni kujdes për përdorimin e vazhdueshëm të të gjitha simboleve të atij lloj shkrimi.*

*Shkronjat latine nuk duhet të zëvendësohen me shkronja të ngjashme nga shkrimi cirilik dhe anasjelltas!*

Edhe pse të dhënat e koduara zakonisht janë në shkrim latin, kodet mund t'i vendosni edhe në shkrim cirilik. Pas shënimit në shkrim cirilik, kodi në mënyrë automatike shndërrohet në shkrim latin.

Kur kërkoni kodet në listën e kodeve në dritaren e ndarë, pyetjen për kërkim duhet ta shënoni në shkrimin e kodeve ose të shkrimit në të cilin është shënuar kuptimi i tyre.



Shënim:

*Kodet që përmbajnë shkronjat x, y, w, q, shënoni vetëm në shkrim latin.*

### 13.2.1.1 Shënimi në fushat me kontroll të njësuar

Në regjistrimin bibliografik, për shënimin e emërimit në disa lloje të shkrimeve, në sistemin COBISS përdoren fushat e përsëritshme 70X, ndërsa fushat janë nën kontrollin e njësuar (shih kap. 13.2.1.2).

Udhëzimet e përgjithshme për shënimin në fushat me kontroll të njësuar janë përshkruar në kap. 7.3.4.1. Në këtë kapitull janë përshkruar vetëm karakteristikat për shkak të përdorimit të shkrimit cirilik:

- Në nënfushën 3 të fushës për emërtimin për emrin vetjak të regjistrimit bibliografik, ashtu si edhe në fushën në dritaren **Lidhja me regjistrimet nga CONOR.XX** pyetjen për kërkim mund ta shënoni në shkrim cirilik ose latin. Në saktësinë e kërkimit ndikojnë këta faktorë:
  - kur regjistrimi i njësuar përmban pikëqasje alternative në shkrim cirilik dhe latin. Duhet të jeni të kujdesshëm në mënyrë të veçantë të emrat e huaj
  - kur përdorni kërkimin me tekst ose me frazë  
Kërkimi me tekst mundëson shënimin e pyetjes për kërkim me simbolet bazë (p.sh. Viola Konig ose Мyp Пейт\* **dhe jo** Viola König ose Мyp Пейт\*), ndërkohë që kërkimi me frazë kërkon shënim të saktë të pyetjes për kërkim me shenja diakritike (p.sh. "König, Viola" **dhe jo** "Konig, Viola").




Këshillë:

Nëse pas shënimit të pyetjes për kërkim nuk keni marrë rezultatin e dëshiruar, kërkimin mund ta përsëritni, duke shënuar formën alternative në shkrim tjetër ose formën tjetër të njohur të emrit.

- Lista e emrave vetjakë nga baza e të dhënave CONOR.XX shfaqet në këtë mënyrë:

- Në fillim të listës ndodhen pikëqasjet në shkrimin cirilik, të klasifikuara sipas alfabetit cirilik (azbuka), ndërsa pas tyre ndodhen pikëqasjet në shkrimin latin të klasifikuara sipas alfabetit latin.
- **Pikëqasjet e njësuara në shkrimet alternative** shfaqen së bashku, forma në shkrimin cirilik me ngjyrë të zezë, ndërsa ajo në shkrimin latin me ngjyrë të kaltër.
- **Variantet e pikëqasjes** së bashku me informacionin e plotësuar për pikëqasjen përkatëse të njësuar shfaqen me ngjyrë të gjelbërt.
- **Pikëqasjet alternative në gjuhë tjetër** shfaqen bashkë me informacionin e plotësuar për pikëqasjen e njësuar në regjistrimin e krijuar në shkrime alternative.




**Figura 13.2-1: Shembull i dritares për lidhjen me regjistrimet nga CONOR.BG**

- Në mënyrë të veçantë duhet të jeni të kujdesshëm në pikëqasjet e njësuara, të cilat janë vetëm në një lloj të shkrimit. Shkrimi i pikëqasjes së përzgjedhur duhet t'i përshtatet gjuhës dhe shkrimit të veprës, të cilën e katalogoni. Kontrolli programor kujdeset që të mos vendosni emërtimin e gabuar në regjistrimin bibliografik. Në raste të tilla përsëritni kërkimin dhe plotësoni regjistrimin e njësuar në përputhje me udhëzimet në kap. 7.3.4.1.1, pika 4.
- Pasi të klikoni në butonin **Lidh** në regjistrimin bibliografik transferohen këto të dhëna:
  - Emërtimi për emrin vetjak paralelisht në dy shkrime, nëse regjistrimi i njësuar përmban pikëqasje alternative. Nëse në regjistrimin e njësuar pikëqasja është vetëm në një shkrim, në regjistrimin bibliografik transferohet emërtimi i emrit vetjak në një lloj shkrimi.
  - Në vendin e parë transferohet emërtimi për emrin vetjak në shkrimin, i cili i përshtatet shkrimit të titullit kryesor në regjistrimin

bibliografik. Për sistemet COBISS.SR, COBISS.CG dhe COBISS.RS aplikohet në rastet e veprave në gjuhën serbe, në mënyrë që në vend të parë të jetë emërtimi i emrit vetjak në shkrimin cirilik.

- Të gjitha pikëqasjet e tjera nga regjistrimi i njësuar. Në sistemin COBISS.BG pikëqasja e njësuar nga fusha 700 në regjistrimin e njësuar transferohet në fushën 904.



**Figura 13.2-2: Shembull i regjistrimit bibliografik në redaktues në sistemin COBISS.BG me emërtim të lidhur të emrit vetjak në shkrime alternative**

### 13.2.1.2 Shënimi i të dhënave në regjistrimin e njësuar në shkrimet alternative

Edhe në strukturën e regjistrimeve të njësuara mund të ekzistoj fusha paralele për pikëqasjet alternative në dy lloje të shkrimit.

Udhëzimet e hollësishtme për procedurat e punës me regjistrimet e njësuara ndodhen në kap. 9. Udhëzimet në këtë kapitull plotësojnë udhëzimet themelore dhe janë paracaktuar vetëm administrimin e të dhënave në shkrimet alternative.

Procedurat në vazhdim kanë të bëjnë me shqyrtimin e pikëqasjeve alternative në procesin e krijimit, redaktimit dhe shkarkimit të regjistrimeve të njësuara.

Regjistrimin e ri e krijoni në dritaren **Regjistrimi i njësuar (CONOR)**.

#### **Procedura**

1. Përzgjidhni metodën **Regjistrimi / Krijo regjistrimin**.

Në redaktues ngarkohen fushat dhe nënfushat e maskës së përzgjedhur për emrat vetjakë (PN), ku fusha 200 është e përsëritshme.

2. Zakonisht i plotësoni të dyja fushat 200.

Në fushën e parë 200 shënoni pikëqasjen e njësuar në shkrim cirilik, ndërsa në nënfushën 7 duhet të vendosni kodin për shkrimin cirilik. Në fushën tjetër 200 shënoni pikëqasjen e njësuar në shkrim latin, ndërsa në nënfushën 7 duhet të vendosni kodin për shkrimin latin. Regjistrimet e njësuara në shkrime alternative mundësojnë administrimin e katalogëve të përgjithshëm në shkrim cirilik dhe latin. Për këtë arsye, për autorët që krijojnë në shkrim cirilik, në fushën e parë 200 shënonohet forma e emrit në gjuhën origjinale. Për autorët, të cilët krijojnë në shkrim latin, në fushën e parë 200 shënohet forma fonetike e formuar sipas rregullave të transkriptimit fonetik në sistemin kombëtar. Për autorët, të cilët krijojnë në shkrim cirilik, në fushën e dytë 200 shënonohet forma e transliteruar e emrit në shkrim latin, ndërsa për autorët, të cilët krijojnë në shkrim latin, forma e emrit në gjuhën origjinale.



**Këshillë:**

Pikëqasjen e njësuar e formoni në të dy llojet e shkrimeve edhe atëherë kur në bazën e përbashkët të të dhënave nuk ka regjistrime bibliografike për veprat në shkrim alternativ.

3. Nëse nuk keni të dhëna për formimin e pikëqasjeve të njësuara në të dy llojet e shkrimeve, plotësoni vetëm një fushë 200 (ose në shkrim cirilik ose në latin), ndërsa në nënfushën 7 duhet patjetër të vendosni kodin për shkrimin.
4. Variantet e pikëqasjes i shënoni në fushat 400.  
Për sa i përket gjuhës dhe shkrimit të burimit bibliografik shënoni variantet e pikëqasjes në shkrim cirilik ose latin. Rekomandohet, që variantet e formave të emrave, të cilët janë të njohur për përdoruesit e katalogut, të shënohen paralelisht në të dy llojet e shkrimeve. Shënimi i kodeve për llojin e shkrimit nuk është i detyrueshëm.
5. Pikëqasjet në lidhshmëri i shënoni paralelisht në të dy llojet e shkrimit në fushat 500.  
Për arsye se pikëqasjet në lidhshmëri paraqiten në regjistrimin tjetër si pikëqasje të njësuara, rekomandohet shënimi i formave alternative.

Nëse regjistrimi nuk përmban pikëqasje të njësuara në shkrim alternativ, atë e plotësoni.

**Procedura**

1. Përzgjidhni metodën **Regjistrimi / Redakto regjistrimin**.  
Në redaktues ngarkohen fushat e plotësuara të regjistrimit të njësuar me vetëm një fushë 200.
2. Shtoni edhe një fushë 200.  
Nëse keni autorizimin CAT\_NEWPN, shtoni fushën 200 përmes metodës **Redaktimi / Shto fushën**, ndërsa në fushë shënoni pikëqasjen alternative në shkrimin tjetër. Nga kjo procedurë janë përjashtuar regjistrimet, për të cilat përgjegjësinë e ka marrë një bibliotekë tjetër.

Nëse nuk e keni autorizimin CAT\_NEWPN, fushën 200 mund ta shtoni vetëm në ato regjistrime, që janë krijuar në bibliotekën tuaj, por që ende nuk janë redaktuar nga kataloguesi me autorizimin CAT\_NEWPN. Në rast të kundërt për plotësimin e regjistrimit duhet të lutni kataloguesin me autorizimin e lartëpërmendur ose redaktorin e bazës CONOR.

Regjistrimet e njësuara mund t'i shkarkoni nga baza e njësuar e të dhënave të Bibliotekës së Kongresit LC/NAF.

### *Procedura*

1. Përzgjidhni metodën **Kërkimi / LC/NAF**. Gjeneroni dhe përzgjidhni regjistrimin.  
Regjistrimi shtohet në kujtesën e fragmenteve të regjistrimeve.
2. Përzgjidhni metodën **Regjistrimi / Shkarko regjistrimin**.  
Në redaktues ngarkohet regjistrimi nga baza e të dhënave LC/NAF, i cili pas konvertimit është përshtatur për përdorim në bazën CONOR. Për shkarkimin e regjistrimit ju duhet autorizimi CAT\_NEWPN.
3. Shtoni edhe një fushë 200.  
Nëse e dini formën alternative të emrit në shkrim cirilik, përmes metodës **Redaktimi / Shto fushën** e shtoni fushën 200, në të cilën shënoni pikëqasjen e njësuar në shkrim cirilik. Fushën me pikëqasje të njësuar në shkrim cirilik mund ta zhvendosni para pikëqasjes alternative në shkrim latin përmes metodës **Redaktimi / Zhvendos lart**.
4. Në të njëjtën kohë përmirësoni dhe plotësoni edhe të dhënat e tjera në regjistrim.

Përveç regjistrimit bazë të njësuar me pikëqasjet alternative në shkrim cirilik dhe latin, në sistemin COBISS.BG ekzistojnë edhe regjistrimet shpesh të njësuara për pikëqasjet në gjuhën bullgare dhe ruse.

### *Procedura*

1. Përzgjidhni metodën **Regjistrimi / Krijo regjistrimin**.  
Në redaktues ngarkohen fushat dhe nënfushat e maskës së përzgjedhur për emrat vetjakë (PN).
2. Plotësoni fushën 200.  
Në fushën 200 shënoni pikëqasjen e njësuar në gjuhën bullgare dhe ruse, pastaj duhet patjetër të vendosni kodin e duhur për shkrimin cirilik në nënfushën 7 dhe kodin për gjuhën në nënfushën 9.
3. Plotësoni fushën 700.  
Në fushat e përsëritshme 700 shënoni pikëqasjet e njësuara për të njëjtin emër nga regjistrimi bazë i njësuar me pikëqasje alternative në shkrim cirilik dhe latin. Në fushat 700 duhet patjetër të plotësoni nënfushën 3, e cila përmban numrin e regjistrimit të njësuar për emrin në fushën 700, dhe nënfushën 7 me kodin e duhur për llojin e shkrimit të pjesës kryesore të pikëqasjes.

4. Për plotësimin e pjesëve të tjera të regjistrimit të njësuar respektoni udhëzimet themelore për regjistrimin e njësuar në shkrime alternative.

## 13.2.2 Kërkimi i të dhënave

Bazat e të dhënave në sistemet COBISS kanë të njëjtat fusha apo indekse për kërkim, pavarësisht se në çfarë shkrimi janë vendosur të dhënat.

Për kërkimin e të dhënave të shënuara në shkrimet e huaja, edhe pyetjet për kërkim duhet të shënohet në shkrimet e huaja. Përjashtim përbëjnë sistemet COBISS në shtetet që përdorin edhe shkrimin latin edhe atë cirilik (COBISS.SR, COBISS.BH, COBISS.RS, COBISS.CG, COBISS.MK), dhe ku pyetja për kërkim mund të shënohet në shkrim latin ose cirilik, ndërsa midis rezultateve të kërkimit do të jenë regjistrimet në të dy llojet e shkrimit. Kjo mundësi nuk ekziston në bazat e huaja të të dhënave, të cilat nuk janë të instaluar në serverin e IZUM-it (Katalogu online i Bibliotekës së Kongresit, WorldCat).

### 13.2.2.1 Regjistrimet bibliografike

Në dritaret për kërkim në bazat lokale dhe të përbashkëta bibliografike në sistemet kombëtare COBISS.SR, COBISS.BH, COBISS.RS, COBISS.CG, COBISS.MK në rrjetin COBISS.Net ose në bazën e ISSN-së, pyetjen për kërkim mund ta shënoni në shkrim latin ose cirilik, me shenja diakritike ose vetëm me shenjat bazë.

Kur dëshironi që kërkimin në bazën lokale ose të përbashkët ta kufizoni vetëm në regjistrimet për burimet në shkrim latin ose vetëm në regjistrimet për burimet në shkrim cirilik, te "Kufizimi" përzgjidhni vlerën *LAT* ose *CIR* (shih kap. 4.1.4). Në kërkimin e avancuar është i mundur kërkimi vetëm me tekst në shkrimin latin, ose vetëm me tekst në shkrimin cirilik. Kërkimi bëhet në këtë mënyrë: midis parashtesës për kërkim dhe termit për kërkim në shkrimin e dëshiruar në vend të një shenje barazimi vendosen dy ose midis termit për kërkim dhe parashtesës për kërkim në vend të një vize të pjerrët vendosen dy.



#### Këshillë:

Gjatë vendosjes së simboleve në pyetjen për kërkim mund të përdorni dritaren **Simbolet COBISS**, të cilën në dritaren për kërkim e hapni duke kombinuar tastet <Ctrl> + <S>.

Nëse në dritaren për kërkim të bazës së të dhënave WorldCat ose në dritaren për kërkim të Katalogut online të Bibliotekës së Kongresit shënoni pyetjen për kërkim në shkrim cirilik, rezultatet e kërkimit janë të kufizuara vetëm në regjistrimet, të cilat përmbajnë të dhëna paralele në shkrim cirilik.

Procedura e kërkimit të regjistrimeve bibliografike është përshkruar në kap. 4.

### 13.2.2.2 Regjistrimet e njësuara

Te kërkimi me fraza në bazën e të dhënave CONOR.XX pyetjen për kërkim duhet ta shënoni në shkrimin, në të cilin është e shënuar pikëqasja në regjistrimin e njësuar.

Gjithashtu, nëse kërkoni pikëqasjet për emrat vetjakë, në pyetjen për kërkim duhet të përdorni shenjat diakritike.

Procedura e kërkimit të regjistrimeve të njësuara është përshkruar në kap. 9.2.

### 13.2.3 Shkarkimi dhe redaktimi i regjistrimeve në sistemet COBISS.SR dhe COBISS.CG



Shënim:

*Ky kapitull i përket sistemeve COBISS.SR, COBISS.CG si dhe pjesërisht sistemit COBISS.RS, derisa të bëhen pjesë e katalogimit me kontroll të njësuar!*

Katalogimi i përbashkët në sistemet kombëtare COBISS.SR dhe COBISS.CG është më kompleks për shkak të shkrimeve të ndryshme të emërtimeve për emrat vetjakë dhe emërtimet lëndore në regjistrimet bibliografike. Bibliotekat universitare dhe speciale deri tani kanë mbajtur katalogë të ndryshëm në shkrim latin, ndërsa biblioteka kombëtare, ato publike dhe të shkollave katalogë në shkrim cirilik (me përjashtim të katalogut bazë latin të librave të huaja në gjuhët latine). Kjo praktikë është ruajtur edhe në katalogët elektronik (OPAC). Shkarkimi i këtyre regjistrimeve bibliografike nga baza e përbashkët në bazën lokale ka kërkuar përshtatjen në mënyrë manuale të të dhënave në regjistrim. Për këtë arsye në programin COBISS2 kanë ekzistuar rregullat për shfaqjen e regjistrimeve bibliografike në të dy llojet e shkrimit, siç ka ekzistuar mbështetja e programit për ndryshimin e emërtimeve alternative për emrat vetjakë.

Në COBISS3/Katalogimi lloji i shkrimit të të dhënave bibliografike shfaqet në bazë të:

- shënimit të të dhënave në shkrimin origjinal (cirilik dhe latin)
- kontrollit të njësuar përmes regjistrimeve të njësuara me pikëqasje alternative (për emrat vetjakë)

Duke pasur parasysh, se hyrja në kontroll të njësuar të të dhënave në shkrimet alternative merr shumë kohë si proces, në COBISS3/Katalogimi, te ndryshimi i shkrimit të emërtimeve në bazat lokale bibliografike, kataloguesve u mundësohet:

- përshtatja automatike e emërtimeve alternative për emrat vetjakë dhe shkrimeve të emërtimeve për emrat vetjakë
- përshtatja e pjesshme automatike e shkrimeve të emërtimeve lëndore dhe të korporatave (fushat 6XX, 7XX dhe 9XX)
- metodat **Redaktimi / Shndërro në shkrim latin dhe Redaktimi /**



### Shndërro në shkrim cirilik serb/maqedon

- metodat kopjimi i fushave, nënfushave dhe tekstit, pastaj metoda e ngjitjes së veçantë për transferimin e një numri më të madh të të dhënave nga një regjistrim bibliografik në tjetrin ose brenda regjistrimin të njëjtë bibliografik

Kushtet për konvertimin automatik të shkrimeve, në të cilët janë shënuar emërtimet në bazën lokale bibliografike të të dhënave, janë:

- gjuha e katalogimit të jetë serbe (100h = "srp")
- lloji i shkrimit të gjuhës së katalogimit në bazën lokale duhet të ndryshoj nga lloji i shkrimit të gjuhës së katalogimit në regjistrimin bibliografik në bazën e përbashkët të të dhënave (0017 ≠ 0017)

Kusht për përshtatjen automatike të çifteve të emërtimeve alternative për emrat vetjakë është:

- prania e varianteve të formave të emrit vetjak në regjistrimin bibliografik, i cili është i përzgjedhur saktë si emërtim alternativ në shkrim latin (fushat 90X, treg. 2 = 0, 3) ose në shkrim cirilik (fushat 90X, treg. 2 = 1, 4)

Nën këto kushte, duke zgjedhur metodën **Regjistrimi / Shkarko regjistrimin** përshtaten në mënyrë automatike shkrimet e të gjitha emërtimeve, kur në redaktues transferohen të dhënat bibliografike nga baza e përbashkët. Përmes metodës **Regjistrimi / Redakto regjistrimin** në mënyrë automatike përshtaten vetëm shkrimet e emërtimeve për emrat vetjakë dhe organizatat, kur në redaktues transferohen emërtimet lëndore nga versioni i regjistrimit në bazën lokale të të dhënave.



Shënim:

*Te shkarkimi i regjistrimit nga baza e të dhënave WorldCat duhet të vendosni në mënyrë manuale kodin për shkrimin e gjuhës së katalogimit (nënfusha 0017). Nëse keni shkarkuar regjistrimin në shkrim cirilik, nga shkrimi latin në atë cirilik duhet të konvertoni edhe shkrimin e shënimeve të përkthyer në mënyrë automatike dhe të dhënave në gjuhën e katalogimit.*

*Të dyja kërkesat vlejnjë vetëm te ato praktika katalogimi, të cilat ekzistojnë vetëm në sistemet, ku gjuha e katalogimit është në dy llojet e shkrimit.*

### 13.2.3.1 Bazat lokale të të dhënave të bibliotekave kombëtare dhe publike

Nëse plotësohen kushtet e përgjithshme, të përshkruara në kap. 13.2.3, bashkërendimi automatik i shkrimeve për emërtimin rrjedh ndryshe në rastin e regjistrimit bibliografik, i cili është krijuar në COBISS2/Katalogimi, por ende nuk është redaktuar në COBISS3/Katalogimi (shenja KAT2), dhe ndryshe në rastin e regjistrimit, i cili është krijuar dhe/ose redaktuar në COBISS3/Katalogimi.

Për regjistrimin, i cili është krijuar në COBISS2/Katalogimi, vlenë si në vijim:

- Kur titulli i saktë është në shkrim **cirilik** (1001 = "c\*"), aplikohet konvertimi automatik i tekstit nga shkrimi latin në cirilik për **të gjitha emërtimet** (FUSHAT 503, 6XX, 7XX dhe 9XX). Kataloguesi duhet të verifikoj dhe sipas nevojës të përmirësoj në mënyrë manuale ose të zëvendësoj:
  - format alternative të emërtimeve për organizatat dhe emërtimeve lëndore (fushat e lidhura 60X e 96X dhe 71X e 91X)
  - emërtimet lëndore, të cilat përmbajnë fjalë të huaja (fushat 6XX)
  - termat lëndorë të pakontrolluar me kodin për gjuhën angleze (fusha 610)
  - variantet e formave të emërtimeve për emrat vetjakë, që duhet të jenë në shkrimin, i cili ndryshon nga shkrimi i formës së njësuar (fushat 90X, treg 2 = 9)
- Kur titulli i saktë është në **shkrim latin** (1001 = "ba"), aplikohet konvertimi automatik i tekstit nga shkrimi latin në cirilik për **emërtimet për emrat vetjakë dhe emërtimet për organizatat** (fushat 503, 7XX dhe 9XX), por **nuk aplikohet për emërtimet lëndore** (fushat 6XX). Kataloguesi duhet të verifikoj dhe sipas nevojës të përmirësoj në mënyrë manuale ose të zëvendësoj:
  - emërtimet lëndore (fushat 60X, 96X dhe 610)
  - format alternative të emërtimeve për organizatat (fushat e lidhura 71X dhe 91X)
  - variantet e formave të emërtimeve për emrat vetjakë, që duhet të jenë në shkrimin, i cili ndryshon nga shkrimi i formës së njësuar (fushat 90X, treg. 2 = 9)



Shënim:

*Nëse në fillim të fushës për emërtimin lëndor është vendosur shenja e kontrollit për shkrimin, me atë do të përcaktohet shkrimi i emërtimeve lëndore edhe pas shkarkimit në bazën lokale të bibliotekës!*

Pavarësisht nga lloji i shkrimit të titullit të saktë (1001 = "c\*" ose 1001 = "ba"), në regjistrimin, i cili është krijuar në modulin COBISS3/Katalogimi, vlenë si në vazhdim:

- Konvertimi automatik aplikohet te **emërtimet për emrat vetjakë dhe emërtimet për organizatat** (fushat 503, 6XX, 7XX dhe 9XX), por **nuk aplikohet te te emërtimet lëndore**. Kataloguesi duhet të verifikoj dhe sipas nevojës të përmirësoj në mënyrë manuale ose të zëvendësoj:
  - emërtimet lëndore (fushat 60X, 96X dhe 610)
  - format alternative të emërtimeve për organizatat (fushat e lidhura 71X dhe 91X)



Shënim:

*Gjatë redaktimit të regjistrimit në redaktues transferohen fushat lokale për përshkrimin e përmbajtjes, ndërsa fushat e tjera transferohen nga regjistrimi në bazën e përbashkët. Gjatë redaktimit të regjistrimit, kataloguesi duhet të verifikoj emërtimet për emrat vetjakë dhe emërtimet për organizatat si dhe variantet e formave të tyre.*

### 13.2.3.2 Bazat lokale të bibliotekave universitare dhe speciale

Nëse plotësohen kushtet e përgjithshme, të përshkruara në kap. 13.2.3, për regjistrimin, i cili është krijuar në COBISS2/Katalogimi dhe ende nuk është redaktuar në COBISS3/Katalogimi (shenja KAT2), vlenë si në vijim:

- Pavarësisht nga gjuha dhe shkrimi i titullit të saktë (1001 = "c\*" ose 1001 = "ba"), konvertimi automatik nga shkrimi cirilik në latin aplikohet në të gjitha fushat 503, 6XX, 7XX dhe 9XX. Kataloguesi duhet të verifikoj dhe sipas nevojës të përmirësoj në mënyrë manuale ose të zëvendësoj:
  - format alternative të emërtimeve për organizatat ose emërtimet lëndore
  - fushat 90X, treg. 2 = 9, nëse varianti i formës së emrit duhet të jetë në llojin e shkrimit, i cili është ndryshe nga shkrimi në fushat 70X



Shënim:

*Për sa i përket shenjave të kontrollit për llojin e shkrimit në regjistrimet me shenjën KAT2 dhe redaktimit të regjistrimit shih shënimet në kap. 13.2.3.1.*

Për regjistrimin, i cili është krijuar në COBISS3/Katalogimi, vlenë si në vijim:

- Pavarësisht nga lloji i shkrimit të titullit të saktë (1001 = "c\*" ose 1001 = "ba"), konvertimi automatik i tekstit nga shkrimi cirilik në latin aplikohet në të gjitha fushat 503, 7XX dhe 9XX. Kataloguesi duhet të verifikoj dhe sipas nevojës të përmirësoj në mënyrë manuale ose të zëvendësoj:
  - llojin e shkrimit në fushat 60X, 96X dhe 610 si dhe emërtimet alternative lëndore
  - emërtimet alternative për organizatat